



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 18.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për ri-shqyrtim të datës 14.12.2020, të parashtruar nga Operatori "Grupi i OE "N.T.SH. Marash-Shped SH.P.K. & Company Zuka Commerce SH.P.K." lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës – LOT 3", me Nr. të Prok: 632-20-4174-5-1-1, nxjerr:

VENDIM

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të "Grupi i OE "N.T.SH. Marash-Shped SH.P.K. & Company Zuka Commerce SH.P.K." e dates 14.12.2020, lidhur me aktivitetin e Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës – LOT 3", me Nr. të Prok: 632-20-4174-5-1-1, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , te AK –së, të datës 08.12.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë 08.12.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

Arsyetim

Operatori Ekonomik Grupi i OE "N.T.SH. Marash-Shped SH.P.K. & Company Zuka Commerce SH.P.K." me datë 14.12.2020, ka parashtruar Kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës – LOT 3", me Nr. të Prok: 632-20-4174-5-1-1,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 18.12.2020, ka shqyrtuar Kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 1 se është bërë shkelje e nenit 6, AK sqaron se nuk ka bërë shkelje të këtij neni pasi që është siguruar që fondet publike janë përdorur në mënyrën më ekonomike.

2. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 2 se është bërë shkelje e nenit 7, AK sqaron se nuk ka bërë shkelje të këtij neni pasi që i trajtuar njësoj të gjithë OE, si dhe ka vepruar konform Vendimit të OSHP duke kërkuar sqarime për secilën pikë konform PSH.

3. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 3 se është bërë shkelje e nenit 56, AK sqaron se nuk ka bërë shkelje pasi që vlerësuar drejtë dhe saktë ofertat e OE dhe sqaron se OE ankues nuk ka saktësuar mangësitë që ka përmendur në Kërkesë për rishqyrtim.

4. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 4 se është bërë shkelje e nenit 59 se nuk ka vendosur në listë inxhinierin e komunikacionit dhe gjeodetin mirëpo për ta ka ofruar dëshmit, AK sqaron se meqenëse për të dy janë ofruar dëshmitë e kërkuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë është konsideruar sipas nenit 59 pika 4 ii "përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit" si devijim i vogël që nuk ka ndikuar në tërësi në vlerësim të projektit në fjalë.

Edhe konform Vendimit të OSHP me nr. 827/20 të datës 24.11.2020 është thënë që për këta dy anëtarë të personelit të OE ka të nënshkruara kontrata mbi vepër meqenëse nuk janë pjesë e stafit të rregullt të kompanisë si dhe ky pretendim ankimor ka qenë i pabazuar edhe sipas OSHP.

Për më shumë shih Vendimin ku në faqe nr. 6 thuhet:

me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, janë hasur dëshmi se OE i rekomanduar për kontratë (ashtu sik ka cek edhe OE ankues) ka ofruar dokumentet e kërkuara, më konkretisht ka ofruar kontrata mbi vepër me emër dhe numër për këto aktivitet të prokurimit. Me gjithë se këta dy emra nuk gjenden në listë të stafit, (pasi që edhe nuk janë staf i rregullt i kompanisë). Andaj, OE i rekomanduar për kontratë plotëson kërkesën e AK-së në dosje të tenderit dhe pretendimi ankimor është i pabazuar.

5. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 5 se është bërë shkelje e nenit 61, AK sqaron se konform Rregullores për tenderë jo-normalisht të ulët neni 4 pika 4.2 A nuk ka konsideruar se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar cmime abnormalisht të ulëta për tender apo pozicion.

6. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 6 se është bërë shkelje e nenit 69, AK sqaron se përgjigjja është dhënë më sipër në pikën nr. 4.

Përpos këtyre, AK sqaron se konform Vendimit të OSHP me nr. 827/20 të datës 24.11.2020 lënda është kthyer në ri vlerësim duke kërkuar sqarime tek OE për pikat ankimore të bazuara.

Tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye se cmimi juaj nuk është më i ulëti në mesin e tenderëve që plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve nga publikimi i Vendimit në platformën elektronike <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës

Faton Gütaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

